



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Memorandum i Mirëkuptimit

në mes të

Rrjetit të Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN) - Qendrës për Polika dhe Avokim (QPA)

dhe

Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK)

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN) me financim të Olof Palme International Center dhe mbështetje të Qeverisë Suedeze, është duke zbatuar projektin “ Pro WO+MAN Gender Resource Hub”.

Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) është duke zbatuar projektin ‘Fuqizimi i Sundimit të Ligjit-Promovimi i të drejtave të punëtorëve/eve. Projekt ky i financuar nga Olof Palme International Center në mbështetje të Qeverisë Suedeze.

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky Memorandum i Mirëkuptimit paraqet një marrëveshje të shkruar në mes Rrjetit të Edukatorëve Bashkëmoshatarë - PEN (në tekstin e më poshtëm referohet si PEN), Qendrës për Politika dhe Avokim – QPA (në tekstin e më poshtëm referohet si QPA).

Sindikata e Policisë së Kosovës (në tekstin e më poshtëm referohet si SPK) përmes së cilës synohet të ofrohet mbështetje SPK-së për të mbështetur krijimin dhe funksionimin e rrjetit të grave dhe promovimin e dialogut social brenda strukturave të brendshme të sindikatës. Përmes sesioneve trajnuese synohet të ngriten kapacitetet e sindikatës për të adaptuar strategjinë e integritit gjinor në punën e tyre dhe strukturën organizative. Në të njëjtën kohë synohet të ngriten kapacitetet e grave sindikaliste për të paraqitur më mirë nevojat e grave dhe për të marrë pozita udhëheqëse brenda strukturave të brendshme të sindikatës si dhe të përfshihen në dialog social.

Parimet e Memorandumit të Mirëkuptimit

PEN, QPA dhe SPK pajtohen që të respektojnë dhe zbatojnë këto parime të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

1. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që të bashkëpunojnë në arritjen e qëllimit të këtij memorandumi.
2. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që të krijojnë/ofrojnë hapësirë për sesionet trajnuese mbi strategjinë e integritimit gjinor dhe dialogut social.
3. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që të angazhojnë stafin për të marrë pjesë në sesionet trajnuese mbi strategjinë e integritimit gjinor dhe dialogut social.
4. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen të ndihmojnë në identifikimin e grave sindikaliste për të qenë pjesë e trajnimeve për ngritje të kapaciteteve.
5. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen të angazhohen për rritjen e pjesëmarrjes së grave në sindikatë dhe në strukturat e saj udhëheqëse.

Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët dhe do të zgjasë deri me 31 dhjetor 2019, përgjatë procesit të zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Në rastet kur njëra palë dëshiron të ndërpresë këtë memorandum, njoftimi duhet të bëhet të paktën dy (2) javë më herët dhe në mënyrë të shkruar.

Bujar Fejzullahu
Drejtor Ekzekutiv

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë – PEN

Milaim Morina
Drejtor Ekzekutiv

Qendra për Politika dhe Avokim - QPA

Valbona Kamberi
Kryetare

Sindikata e Policisë së Kosovës - SPK

Data dhe Vendi:
